

HISTORIA DHE POPUJT E BALLKANIT

Në periudhën e sotme, popujt e Ballkanit synojnë të jenë pjesë e Bashkimit Europian. Ata janë në një proces integrimi me vendet më në zë të Europës. Po fillon kështu një erë e re, e cila shpresojmë të jetë e mbarë. Në këtë rast është e kuptueshme, të shtrohet edhe kërkesa që të rishihet historia e tyre, duke përdorur një terminologji të njëjtë, me një këndvështrim më të gjerë, veçanërisht duke u hequr teksteve shkollore frymën denigruese dhe nxitjen e urrejtjes midis popujve. Kosova e para plotësoi kërkesën e Bashkimit Europian, për të riparë e rishkruar tekstet e historisë së popujve të Ballkanit për klasat e ulëta. Specialistët përkatës i përgatitën dhe u botuan edhe tekste të klasave të ulëta të vendeve të Ballkanit. Botimi i këtyre teksteve nuk solli asnjë shqetësim, por përkundrazi ato u diskutuan nga komisionet e vendeve përkatëse. Ato u ribotuan për të plotësuar nevojat e shkollës. Kërkesa e shtruar në Prishtinë nga Ministri turk i arsimit shkaktoi çuditërisht një reagim aspak miqësor nga disa intelektualë apo historianë shqiptarë, duke e paraqitur me të madhe në media këtë shqetësim të tyrin.

Historia e popujve të Ballkanit në disa aspekte është një histori e trishtuar. Shumë beteja e ndeshje me armë kanë ndodhur midis tyre. Porse shqiptarët, në mënyrë të veçantë, nuk kanë sulmuar asnjë nga shtetet e tjera. Ndonëse një popull i vogël, ata kanë luftuar për lirinë dhe pavarësinë e tyre dhe kanë përjetuar pushtime të ndryshme. Ata kanë derdhur edhe gjakun për të mbrojtur tokat e trojet e të parëve tyre dhe kanë vuajtur nga të huajt që i robëronin.

Shqetësimi i intelektualëve shqiptarë ka të bëjë me ruajtjen me çdo kusht të historisë sonë kombëtare. Kjo është edhe detyra e tyre: ata lipset të shkruajnë historinë mbi bazën e fakteve dhe dokumenteve, por edhe duke mënjanuar përbuzjen e urrejtjen për popujt e tyre fqinjë. Këto kërkesa të drejta duhet të jetë në mendjen e punën e çdo intelektualit shqiptar. Nuk përbëjnë problem çirret e huliganëve nëpër stadione apo tubime të tjera. Kjo tregon se këta njerëz duhen izoluar nga shoqëria ku bëjnë

pjesë. Përpos kësaj, këto grupe të veçuara ende nuk e dinë se historia nuk përsëritet njëllor si më parë. Në periudhën e sotme, kanë ndryshuar pozitivisht marrëdhëniet midis vendeve dhe popujve të Ballkanit, sepse ato duhet të zhvillohen në dobi të bashkëpunimit dhe të integritetit evropian.

Në kushtet e reja të krijuara, për historinë e popujve të Ballkanit shumë formulime të vjetra të kësaj historie ka nevojë që të rishihen, të korrigjohen e pse jo, disa të tjera edhe duhet të fshihen fare. Ato janë shkruar nën ndikimin negativ të ideologjisë së kaluar moniste, kur për gjithçka vendoste shteti komunist, ndërsa në vende të tjera, nxiteshin nga fanatikë e çetnikë luftënxitës me qëllime të mbrapshta e shoviniste. Është e nevojshme, që, duke shfrytëzuar arkivat reciproke, me konsensus, larg çdo ndikimi ogurzi të nacionalizmit të sëmurë të dikurshëm e të kohës sonë, me marrëveshje shkencore, me autoritet shkencor të bihet në ujdi, që Ballkani të mos jetë foleja e fundit e polemikave pa cak e kufij, duke u larguar sa më shpejt nga nacionalizmi demode që e ushqente diktatura komuniste.

Dihet se çdo popull është i ndjeshëm ndaj historisë së tij dhe të vendit të vet. Kjo kërkon që historianët të kenë një formim të gjerë profesional dhe një horizont bashkëkohor, në kuptimin e dukurive të reja që shtron aktualisht koha e sotme. Në këtë kuptim, edhe historianëve tanë, kur të shkruajnë historinë tonë, u bie ta shkruajnë drejt, pa shtrembërime, madje edhe ta pasurojnë me fakte e të dhëna të reja. Ka ngjarje e dukuri, ka personalitete që nuk përmenden fare, ose shumë shkarazi, ose ka historianë të cilët nuk arrijnë të bëjnë përgjithësime. Kjo është koha, kur historianët mund të shkruajnë të lirë, sepse ndaj asnjërit prej tyre nuk ushtrohet presion politik me qëllimin e keq për ta shtrembëruar historinë, apo kronologjinë e ngjarjeve ose të figurave atdhetare kombëtare. Pas proceseve demokratike të viteve '90, veç popullit, edhe historiografia jonë u çlirua nga pozitat e politizimit të detyruar dhe të deformimit të dhunshëm të ngjarjeve historike. Kështu, shpresohet se Ballkani, së bashku, do të marrë frymë të lirë, me respekt reciprok dhe me dashamirësi njerëzore.